



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.106, Datë 26.06.2019

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TRGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, mbasi shqyrtoi relacionin plotësues të përgatitur me nr.51/10-1, datë 20.06.2019, në vijim të relacionit të diskutuar më herët në mbledhjen e bordit, nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike., Bordi i ERE-s ne vijim të relacionit plotësues me nr.prot 51/10-1 prot, date 20.06.2019:

Konstatoi se:

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.124 Prot., datë 06.02.2019, dhe nr. 124/1 Prot., datë 14.02.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike.
- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datë 31.05.2019, shoqëria “SANG 1” sh.p.k e cila kishte aplikuar për licencim në të aktivitetin e prodhimit dhe tregëtimit, me vendimin nr.83, u licensua dhe ne veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC “Thirre”.
- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datës 31.05.2019 u kërkuar që të sqarohet me shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në një seancë dëgjimore, vlera financiare e vënë në dispozicion për secilën veprimtari, pasi ajo e deklaruar nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k, nuk rezulton e mjaftueshme për të dy veprimtaritë.
- Në seancën dëgjimore të datës 10.06.2019, përfaqësuesit e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., deklaruan se shuma e deklaruar do të shërbejë për veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike

- Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjise elektrike (neni 9, pika 4.8 gërma “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë e shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI